

**APLIKIM PËR ÇMIMIN E SHITJES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE ME PAKICË PËR
VITIN 2020**

Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a.

Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023
Tiranë

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	3
1.1	Vështrim i Përgjithshëm.....	3
1.2	Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura	6
1.3	Indeksi i ndryshimit vjetor të çmimit të konsumit	7
1.4	Kursi i Këmbimit Valutor	7
1.5	Aktivite në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë	8
II.	PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI PËR KONSUMATORËT FUNDORË ...	18
2.1	Të Dhënat dhe Metodologjia Bazë	18
2.2	Parashikimi sasisë së energjisë për klientë që furnizohen nga OSHEE 2019 - 2024	19
2.3	Parashikimi sasisë së energjisë për klientë që do dalin në Tregun e Lirë 2019 - 2024.....	19
2.4	Parashikimi sasisë së energjisë për klientë që do të Furnizohen nga Shërbimi Universal 2019 - 2024 20	
2.5	Bilanci Energjitik 2017 - 2024.....	20
III.	SHPENZIMET PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE	21
3.1	Shpenzime për blerjen e energjisë për Shërbimin e Furnizimit Universal.....	21
3.2	Shpenzime për transmetimin dhe çmimi mesatar i blerjes.....	22
IV.	PËRLLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX).....	22
4.1	Përmbledhje për shpenzimet operative	22
V.	E ARDHURA E KËRKUAR PËR FURNIZUESIN SHËRBIMIT UNIVERSAL.....	26
5.1	Amortizimi	26
5.2	Marzhi i fitimit.....	27
5.3	Kosto e lejuar e Kapitalit të Punës	27
5.4	Kompensimi për Borxhin e Keq	27
VI.	PROPOZIM PËR ÇMIMIN E SHITJES ME PAKICW PWR VITIN 2020 NGA FSHU..	28

I. PËRMBLEDHJE

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Detyrimi ligjor për përlogaritjen e çmimit të shitjes me pakicë për klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal bazohet në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” Nr. 43/2015 datë 30.04.2015, “Rregullores për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurat e ERE-s” si dhe Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal aprovuar nga ERE më 23.11.2017.

Krijimi ligjërishit i shoqërisë FSHU në 28.03.2018 mundësoi fillimin e strukturimit të saj dhe në mënyrë që të jetë plotësisht funksionale në zbatim të liçencës së shitjes me pakicë të energjisë për klientët tariforë. Për arsye të fazës përgatitore të organizimit të FSHU por edhe për shkak të procesit të zgjatuar të ndarjes së OSHEE në shoqëri bija, FSHU nuk arriti ta bënte atë akoma funksionale ushtrimin e liçencës së marrë gjatë periudhës 2018 – 2019 e cila ju rikthye përkohësisht OSHEE deri në ndarjen përfundimtare të shoqërisë e cila do të fillojë të funksionojë plotësisht në fillim të vitit 2020.

OSHEE prej krijimit dhe deri në fund të vitit 2019 vazhdon të ushtrojë aktivitetin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike. Ndryshimet rrënjësore në administrimin e këtij aktiviteti krahas atij të shpërndarjes së energjisë elektrike prej fundvitit 2014, sollën përmirësime dhe suksese të jashtëzakonshme në performancën financiare të OSHEE, e cila brenda një kohe të shkurtër 2015 – 2018 arriti të akumulonte një fitim neto prej rreth 38 miliard Lekë, ndërkohë që prej krijimit të shoqërisë në vitin 2007 dhe deri në fund të vitit 2014 kishte akumuluar vetëm humbje të vazhdueshme për çdo vit për një total prej rreth 104 miliard Lekë.

Me kalimin 100% të aksioneve në pronësi të Shtetit Shqiptar, menaxhimi dhe strategjia e shoqërisë OSHEE janë pjesë e strategjisë kombëtare që Qeveria po ndjek në të gjithë sektorët, përfshirë këtu sektorin energjistik pjesë e të cilit është kjo shoqëri.

Si pjesë e strategjisë së zhvillimit të sektorit Qeveria Shqiptare hartoi platformën e Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike në fillim të vitit 2015, e cila u pasua nga Plani i Konsolidimit Financiar të Sektorit Publik Elektroenergjitik miratuar në Prill 2019, ku fokusi kryesor ishte përmirësimi i treguesve të performancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe joteknike, rritja e normës së arkëtimit me qëllim krijimin e një shoqërie financiarisht të qëndrueshme për të garantuar furnizimin e energjisë elektrike konsumatorëve. Në vazhdim të reformave të ndërmara u aprovua në Parlament ligji Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjië” datë 30.04.2015 i cili ndryshoi tërësisht modelin aktual të tregut të energjisë. Në këtë kuadër krahas punës për përmirësimin e treguesve të përcaktuar në platformë sa më sipër OSHEE është përgatitur për ndryshimet që lidhen me tregun e liberalizuar të shërbimeve të shitjes dhe shpërndarjes duke filluar nga 1 Janar 2020.

Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Në zbatim të platformës së hartuar nga Qeveria Shqiptare dhe me mbështetjen tërësore të saj OSHEE hartoi një program të detajuar ndërhyrjeje në të gjithë vendin i cili bëri të mundur frenimin e humbjeve dhe përmirësimin e treguesve ekonomik – financiarë të shoqërisë në një periudhë të shkurtër. Lufta kundër paligjshmërisë, përmirësimi i shërbimeve dhe arkëtimi i detyrimeve të prapambetura janë në qendër të punës së përditëshme për menaxhimin e OSHEE krahas përmirësimit dhe modernizimit të rrjetit.

Duke filluar nga 1 Korrik 2016 OSHEE në rolin e Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe në zbatim të Modelit të Tregut të aprovuar duhet të sigurojë furnizimin e sasisë së konsumuar nga klientët tariforë, për të cilën krahas blerjes së energjisë së prodhuar nga KESH me çmim të rregulluar duhet të blejë gjithë energjinë e prodhuar nga HEC-et private si dhe të blejë diferencën e energjisë në treg.

Viti 2017 ishte një vit i vështirë për gjithë sektorin e energjisë elektrike në Shqipëri për shkak të thatësisë që uli në mënyrë drastike prodhimin vendas të KESH dhe HEC-ve private duke detyruar OSHEE të blejë energji në tregun e lirë me çmim mesatar 8.9 Lekë/Kwh nga 3 Lekë/Kwh që ishte planifikuar. OSHEE shpenzoi 14.2 miliard Lekë më shumë se vlera e planifikuar për blerjen e energjisë elektrike.

Rezultatet e vitit 2018 megjithëse positive nuk arritën tregusit e performancës së planifikuar në fillim të periudhës si rezultat i rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë, e cila u ndikua nga ndryshimi i strukturës së blerjes dhe rritja e çmimit të blerjes së energjisë elektrike në tregun e lirë. Sasia e prodhuar nga burimet hidrike vendase në vitin 2018 ishte më e madhja e prodhuar ndonjëherë, por kjo rritje u evidentua kryesisht në 6 – mujorin e I-rë i cili ishte shumë i lagesht, ndërsa tremujori i II-të u karakterizua nga thatësi e madhe e cila rriti tej planifikimit importin e energjisë në këtë pjesë të vitit.

Gjatë 2018 shpenzimet për blerje dhe transmetim energjie rezultuan 14 % ose 3.5 miliard Lekë më të larta se ato të planifikuara në fillim të vitit dhe çmimi mesatar i blerjes së energjisë ishte 5.32 Lekë/Kwh nga 4.07 Lekë/Kwh i planifikuar. Faktorët që ndikuan në rritjen e kostos së blerjes së energjisë ishin:

- *Ndryshimi i strukturës së furnizimit në OSHEE si rezultat i detyrimit për të blerë me përparësi energji të prodhuar nga HEC-et private me çmim rreth 8.56 Lekë/Kwh.*
- *Energjia e furnizuar nga KESH më e ulët se planifikimi*
- *Rritja e çmimit të energjisë në tregun e lirë*

Viti 2019 është sërish një vit i thatë dhe për shkak të mosplotësimit të sasisë së planifikuar të furnizimit nga KESH i cili do të furnizojë OSHEE në vetëm rreth 70% të sasisë së planifikuar dhe rreth 65% të sasisë së furnizuar në vitin 2018, kosto e blerjes së energjisë pritet të rritet ndjeshëm. OSHEE do të shpenzojë rreth 13.1 miliard Lekë më shumë se sa planifikimi për blerje

të energjisë në vitin 2019 dhe rreth 9.3 miliard Lekë më shumë se sa në vitin 2018. Kosto e blerjes së energjisë për vitin 2019 pritet të jetë 5.91 Lekë/Kwh nga 4.13 Lekë/Kwh që ishte planifikuar. Parashikimi i performancës financiare të OSHEE për vitin 2019 tregon për një **humbje financiare prej rreth 7.7 miliard Lekë.**

Ndikimi negativ i Rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë në rezultatin e vitit 2018 dhe 2019 u zvogëluar nëpërmjet masave të marra në përmirësim të treguesve ekonomik-financiare, të cilat synojnë:

- ✓ Zvogëlimin e humbjeve jo-teknike nëpërmjet forcimit të kontroleve në rrjet, ndërprerjes së lidhjeve të paligjshme dhe vendosjes para ligjit të abuzuesve si dhe nëpërmjet investimeve që përmirësojnë teknologjinë dhe organizimin e punës.
- ✓ Zvogëlimin e shpenzimeve operative nëpërmjet masave të marra për kontrollin rigoroz të tyre.
- ✓ Rritjen e arkëtimit nëpërmjet politikave të ristrukturimit të borxhit dhe përmirësimit të marrdhënieve me klientët duke përmirësuar shërbimin dhe rritur besimin reciprok.
- ✓ Rritjen e efikasitetit të punës së punonjësve të shoqërisë nëpërmjet masave organizative, rritjes së kualifikimit dhe motivimit të punonjësve.
- ✓ Përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike nëpërmjet investimeve në teknologji të përparura që përmirësojnë treguesit teknikë të furnizimit.
- ✓ Zvogëlimin e kohës së ndërprerjeve teknologjike dhe të kohëzgjatjes së riparimit të defekteve në rrjet.

1.1.1 Statusi Ligjor i Shoqërisë

Në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë” datë 30.04.2015 shoqëria është duke përfunduar procesin e ndarjes administrative dhe menaxheriale të aktiviteteve të saj në plotësim të kërkesave të ligjit “Për Sektorin e Energjisë” për ndarjen e aktiviteteve të cilat nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Këto ndryshime do të sjellin sigurisht edhe ndryshime në statusin ligjor të shoqërisë që sipas kërkesës së ligjit duke filluar nga 01.01.2020.

Në zbatim të këtij ligji dhe të VKM 244 “ Për miratimin e kushteve për vendosjen e Detyrimit të Shërbimit Publik ndaj të liçensuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike...” ERE me vendimet Nr.98 datë 17.06.2016 dhe Nr. 112 datë 08.07.2016 vendosi miratimin e liçencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike dhe përcaktoi FSHU për detyrimin e shërbimit universal.

Për shkaqe objektive në rrethanat e krijuara, sikurse u shpjegua në pjesën e 1.1 Vështrim I Përgjithshëm, FSHU do të fillojë operimin si një shoqëri e pavarur prej datës 01.01.2020, në zbatim të detyrimeve sipas kushteve të përshkruara në liçencën e Shërbimit Universal.

1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara për vitin 2020 kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. Çmimet për Shërbimit për Furnizuesin Universal me të cilat KESH, HEC private dhe OST i shesin energji dhe shërbim transmetimi FSHU janë supozuar në 1.5 Lekë/Kwh për energjinë e blerë nga KESH, 8.46 Lekë/Kwh nga HEC private dhe 0.75 Lekë/Kwh për shërbimin e transmetimit nga OST.
- ii. Energjia për klientë tariforë që furnizohen nga shërbimi universal do të mbulohet nga energjia e prodhuar nga KESH dhe diferenca do të blihet në Tregun e Lirë të energjisë.
- iii. Sasia e energjisë së mbetur nga prodhimi i HEC-ve private pas plotësimit të sasisë së humbjeve në rrjet nga OSSH do të përdoret nga FSHU duke zvogëluar sasine e energjisë së blerë në Tregun e Lirë.
- iv. Çmimi i energjisë së blerë në Tregun e Lirë bazohet në parashikimin sipas monitorimit të tregut 2019 dhe mund të ndryshojë duke u llogaritur si kompensim në vitet e ardhshme të përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë me pakicë të energjisë.
- v. Përlllogaritja e kërkesës për energji është bazuar gjithashtu në strukturën aktuale dhe parashikimin për vitin në vazhdim por që në varësi të ndryshimeve të kërkesë së konsumatorëve tariforë mund të jetë gjithashtu objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera.
- vi. Zhvillimet pozitive të ekonomisë Shqiptare janë marrë parasysh në moslllogaritjen e ndonjë faktori jo pozitiv në provigjionime të mundshme për efekt të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë që mund të përkthehet në rreziqe të rritjes së menjëhershme të shpenzimeve.

Sasia e energjisë që do të shitet për konsumatorët tariforë për vitin 2020 parashikohet të jetë 5,090 Gwh.

Shpenzimet Operative në kushte të një shoqërie të re dhe pa shpenzime historike janë llogaritur bazuar në studimin bashkëngjitur, në të cilin për shpenzimet operative të OSHEE e të njëjtës natyrë janë ndarë duke përdorur koeficientë të ndryshimit bazuar në faktorë të përbashkët. Menaxhmenti i shoqërisë i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve megjithatë është ndeshur me nevojën e rritjes të disa prej tyre nga viti në vit për të rritur performancën duke ushtruar një kontroll më të madh në përmirësimin e sistemit të faturimit.

Kostot e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara kanë sjellë shpenzime për penaltete të cilat rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë të cilat sipas metodologjisë nuk janë marrë parasysh në llogaritje.

Llogaritja e borxhit të keq bazuar në metodologjinë e tarifave miratuar nga ERE është llogaritur duke mesatarizuar të dhënat e pritshme nga arkëtimi i detyrimeve korente për vitin 2020 sipas planit të akrëtitimit në Planin e Rimëkëmbjes Financiare miratuar me VKM prej 95%.

Nga përlllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura në vitin 2020 në llogaritjen e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike rezulton të jetë rreth **58.7miliard Lekë**.

1.3 Indeksi i ndryshimit vjetor të çmimit të konsumit

Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave INSTAT janë marrë të dhënat e grafikut të mëposhtëm të cilat tregojnë se indeksi i çmimit të konsumatorit për vitin në vazhdim 2019 tenton të jetë rreth 1.3%.



Megjithë sa më lart mbështetur në të dhënat shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë si dhe në pritshmërinë e treguesve ekonomikë të Shqipërisë në përlllogaritjet për tarifë kemi konsideruar një koeficient inflacioni prej 3%.

1.4 Kursi i Këmbimit Valutor

Sipas të dhënave të mëposhtme të marra nga faja në internet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit EURO/Lekë 2019 si në grafikun më poshtë dhe tendencës për vitin 2020, kursi i këmbimit për energjinë e importit është marrë 1EURO= 123 Lekë.



1.5 Aktivitete në përmirësim të treguesve tekniko-ekonomikë të Shoqërisë

1.5.1 Treguesit Kryesorë të krahasuar të OSHEE gjatë vitit 2019 (e pritshëm)

Treguesit kryesorë të performancës së OSHEE (të pritshëm) gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 paraqiten në tabelën si më poshtë:

000/Lekë	Përshkrimi	2017	2018	Parashikim 2019	Diferenca 2019-2018	%
Të Ardhurat	Të ardhura nga Shitja e energjisë	52,893,726	53,972,323	55,903,828	↑ 1,931,505	104%
	Të ardhura nga kamatëvonesat	1,104,307	1,089,313	1,088,023	↓ (1,289)	100%
	Të ardhura nga Shpërndarja (Lidhje të reja)	649,137	674,851	722,045	↑ 47,194	107%
	Të tjera	5,675,266	868,519	183,842	↓ (684,677)	21%
	Gjithsej	60,322,436	56,605,006	57,897,738	↑ 1,292,733	102%
Shpenzimet	Shpenzime Energji dhe Transmetim	39,606,411	34,193,492	43,940,149	↓ 9,746,658	129%
	Shpenzime Operative	12,222,982	11,339,486	15,369,297	↓ 4,029,811	136%
	Provizione	2,651,553	4,745,583	2,799,461	↑ (1,946,121)	59%
	EBITDA	5,841,491	6,326,445	(4,211,170)	↓ (10,537,615)	-67%
	Amortizimi	2,528,909	3,086,800	3,208,160	↓ 121,360	104%
	Shpenzime Financiare	16,515	(45,179)	247,561	↓ 292,740	-548%
	Tatim Fitimi	1,575,808	1,337,449	-	↑ (1,337,449)	0%
	Gjithsej	58,602,176	54,657,630	65,564,629	↓ 10,906,999	120%
REZULTATI I AKTIVITETIT		1,720,261	1,947,375	(7,666,891)	↓ (9,614,266)	-394%
	Të ardhura të Jashtëzakonëshme	109,899	-	-		
REZULTATI I PERIUDES		1,830,160	1,947,375	(7,666,891)	↓ (9,614,266)	

ENERGJI (MHW)

	Energji e Blerë	6,498,321	6,436,911	6,547,677	110,766
	Energji e Shitur	4,781,998	4,883,784	5,059,704	175,921
	Energji e Shitur FMF		14,624		
Humbje %		26.41%	23.90%	22.73%	↑ -1.18%

Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të OSHEE gjatë vitit 2019 si më poshtë:

- *Rezultati financiar i vitit 2019 pritet të jetë një humbje prej 7.7 miliard Lekë duke shënuar rezultatin e parë negativ pas 4 viteve me performancë të suksesshme. Rritja e kostos së blerjes së energjisë elektrike për shkak të thatësisës është treguesi kryesor që ka ndikuar në humbjen e pritshme pavarësisht masave të marra për uljen e kostove të operacionale të shoqërisë.*

- *Rritje e shpenzimeve për energjinë e blerë:* Gjatë 2019 shpenzimet për blerje dhe transmetim energjie rezultuan 29% ose 9.7 miliard Lekë më shumë se 2018. Si rezultat i thatësirës së zgjatur prodhimi dhe furnizimi me energji nga KESH me çmim të rregulluar 1.5 Lekë/Kwh u ul ndjeshëm duke detyruar shoqërinë të blejë energji në tregun e importit me çmim mesatar prej rreth 9.2 Lekë/Kwh. Kosto e energjisë së blerë për tariforët për shkak të mosfurnizimit nga KESH pritet të jetë 5 Lekë nga 4.13 Lekë të planifikuar me një efekt prej rreth 5.6 miliard Lekë më shumë.
- *Rritje e të Ardhurave nga Energjia:* Të Ardhurat nga Shitja e Energjisë pritet të rezultojnë 4% më të larta ose 1.9 miliard Lekë më shumë, kushtet e thatësirës dhe verës së nxehtë rritën ndjeshëm përdorimin e enrgjisë elektrike.
- *Të ardhurat nga kamatëvonesat mbeten në të njëjtin nivel me ato të vitit 2018 dhe 2017:* Përgjithësisht masat e marra në aksionin kundër lidhjeve të paligjshme dhe në përmirësimin e arkëtimeve kanë përmirësuar ndjeshëm marrdhënien e OSHEE me klientët duke rritur ndjeshëm arkëtimet. Rritja e pagesave në afat si dhe politikat e ristrukturimit të detyrimeve kanë sjellë uljen e të ardhurave nga kamatëvonesat në krahasim me periudhën 2014 – 2016.
- *Shpenzimet operative për 2019 pritet të jenë 36% më të larta se ato të vitit 2018.* Me gjithë kujdesin e treguar nga drejtimi menaxherial I shoqërisë për shkak të rritjes së penalteteve (nga KESH për mospagesa të faturave të energjisë përpara vitit 2015 prej 2.3 miliard Lekë, si dhe për çështje përbarimore) shpenzimet operative do të rriten, ndonëse të gjithë treguesit e tjerë të shpenzimeve operative tregojnë ulje të ndjeshme në krahasim me treguesit e planifikuar.
- Arkëtimet pritet të jenë sa 97% e vlerës së faturuar e cila është 2% më e lartë se parashikimi në buxhet si dhe në Planin e Rimëkëmbjes prej 95%.
- Shpenzimeve financiare lidhet kryesisht me ndryshime në normat e këmbimit për kreditë e trashëguara në monedha të ndryshme.
- OSHEE ka paguar 100% faturat korente ndaj KESH, OST dhe Posta Shqiptare si dhe 1.2 miliard Lekë më shumë ndaj KESH për kredinë ndaj EBRD.

1.5.2 Paraqitja e aktivitetit të shitjes me pakicë të energjisë për periudhën deri në Shtator 2019

1. Treguesit mbi numrin e klientëve të shërbyer dhe marrëdhënia kontraktuale

Numri i klientëve aktivë të faturuar në FSHU-s gjatë 11 mujorit të 2019 ishte 1,259,277, që është rreth 1.9% më i lartë se numri i klientëve aktiv në fund të vitit 2018.

Rritje vërehet në kategorinë familjarë, në të njëjtat vlera të projeksioneve të rritjes së popullsisë përdorur në parashikimin e kërkesës për energji, dhe po ashtu rritje vërehet dhe në kategorinë privatë, buxhetorë dhe jo-buxhetorë.

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Peshën më të lartë specifike në numrin e klientëve e mbartin klientët familjarë në masën 86%, duke vijuar me trendin e viteve pararendëse.

Klientët Sipas kategorisë

Kategoria	2016	2017	2018	11M 2019
Buxhetor	8,763	9,010	9,548	9,852
Jo buxhetor	3,129	3,152	3,233	3,294
Privatë	147,695	152,219	157,467	161,769
Familjarë	1,028,994	1,045,577	1,065,029	1,084,362
SHUMA	1,188,581	1,209,958	1,235,277	1,259,277

Numri i Klientëve sipas nivelit të tensionit:

Lloji Tensioni matjes	2016	2017	2018	11M 2019
Tension i Mesëm 35Kv	85	89	79	103
Tension i Mesëm 20/10/6 kv	369	420	472	656
Tension i Mesëm 20/10/6 kv Matje TU	4,883	5,946	6,232	6,421
Tension i Ulet Jo familjar	154,250	157,926	163,465	168,036
Tension i Ulet Blloku Familjar	1,028,994	1,045,577	1,065,029	1,084,362
Total	1,188,581	1,209,958	1,235,277	1,259,578

Gjatë periudhës që u mbyll më 11/2019, OSHEE ka instaluar një total prej 48,501 matësa nga të cilët rreth 46% në klientë të rinj dhe 54% në ndryshime matësish, ku peshën më të lartë e mbartin zonat e Tiranës (30% e totalit), Elbasanit (28% e totalit) dhe Shkodrës (13,6% e totalit).

Lidhjet e reja dhe Matësa te Instaluar gjatë periudhës 11/2019

Muaj/Viti	Njësia	Lidhje të reja me matës	Lidhje të reja total	Ndryshimet e matësave	MATESA TE INSTALUAR 2019
Janar	Nr.	1,583	1,583	2,981	4,564
Shkurt	Nr.	1,688	1,688	2,378	4,066
Mars	Nr.	1,683	1,683	607	2,290
Prill	Nr.	1,712	1,712	644	2,356
Maj	Nr.	2,327	2,327	1,546	3,873
Qershor	Nr.	1,880	1,880	406	2,286
Korrik	Nr.	1,923	1,923	1,452	3,375
Gusht	Nr.	898	898	2,018	2,916
Shtator	Nr.	2,456	2,456	5,319	7,775
Tetor	Nr.	3,794	3,794	4,263	8,057
Nëntor	Nr.	2,282	2,282	4,661	6,943
Total	Nr.	22,226	22,226	26,275	48,501

Treguesit më lart, janë realizim në përpjekjet për realizimin e planeve të punës së OSHEE’së për kthimin në ligjshmëri të veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike. Në këto përpjekje OSHEE është mbështetur fuqishëm nga Qeveria Shqiptare dhe institucionet në varësi të saj.

Gjatë periudhës 11/2019 OSHEE ka realizuar rreth 304 mijë kontrolle, rreth 81 mijë ndërprerje të energjisë elektrike dhe në 8 raste është marrë masa e ndalimit për punonjës të OSHEE.

Adresa : Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

Kontrolle gjatë periudhës 11/2019

Muaj	Njësia	Kontrolle	Ndërprerje energjie	% e Ndërprerjeve
Janar	Nr.	27,244	8,809	32.3%
Shkurt	Nr.	22,017	6,450	29.3%
Mars	Nr.	14,339	4,755	33.2%
Prill	Nr.	33,273	6,561	19.7%
Maj	Nr.	34,636	6,160	17.8%
Qershor	Nr.	30,784	5,547	18.0%
Korrik	Nr.	32,803	7,035	21.4%
Gusht	Nr.	32,560	6,206	19.1%
Shtator	Nr.	27,244	8,809	32.3%
Tetor	Nr.	25,073	11,797	47.1%
Nëntor	Nr.	24,790	8,539	34.4%
Total	Nr.	304,763	80,668	26.5%

Statusi i Verifikimit	Njësia	Total 11M 2019
Ndalim punonjës OSHEE	Nr.	8
Total	Nr.	8

2. Treguesit mbi sasitë e furnizuara me pakicë të energjisë elektrike

Sasitë e faturuara / furnizuara

Periudha Janar – Nëntor 2019 u karakterizua nga rritje të sasisë së faturuar ndaj klientëve në masën 4.5%, ose rreth 198mije Mwh më shumë, duke arritur në 4,585 Gwh 2019 kundrejt 4,386 Gwh në të njëjtën periudhë 2018. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e ndikimit të faktorëve si më poshtë:

- Rritjes së kontrolleve në terren për reduktimin e akteve të paligjëshme në rrjet.
- Rritjen e përdorimit nga klientët
- Rritjen e kontrolleve të brendshme me qëllim realizimin në kohë dhe me saktësi të leximeve në matësa nga stafi i zonave të shërbimit
- Efekti i investimeve në rrjet
 - përmirësimin e cilësisë së sistemit të shpërndarjes dhe uljen e kohës së ndërprerjeve.
 - investime në rrjetin e tensionit të mesëm (6-20 kV) që përfshijnë linjat kabllore TM dhe kabina TM/ TU të shpërndarjes, si dhe sistemin e matjes në kabina.

Vëllimi i shitjeve të furnizuara

Vlera e energjisë elektrike në fund të periudhës 11-mujore 2019 arriti në vlerën 60.8 miliard Lekë (me TVSH). Ky tregues paraqet një rritje në masën 4.5 % krahasuar me të njëjtën periudhë

të vitit të kaluar, ose 2,612 milion lekë më shumë. Respektivisht 60.8 miliard Lekë në periudhën 11-mujore 2019 në krahasim me 58.2 miliard Lekë në periudhën 11-mujore 2018.

Vëllimet e Shitjes në Lek 2014-11M 2019 (përfshirë TVSH)

Muaj/Viti	Njësia	2015	2016	2017	2018	11M 2019	11M 2019 / 11M 2018
Janar	000 Lek	5,429,180	5,858,960	6,188,833	5,932,326	6,702,396	12.98%
Shkurt	000 Lek	5,471,713	5,317,092	5,319,702	5,739,384	5,813,085	1.28%
Mars	000 Lek	5,467,483	5,381,949	5,137,827	5,670,315	5,491,121	-3.16%
Prill	000 Lek	4,833,378	4,699,751	4,855,182	4,666,413	5,150,728	10.38%
Maj	000 Lek	4,403,271	4,707,198	4,664,240	4,724,094	5,071,063	7.34%
Qershor	000 Lek	4,573,290	4,789,139	4,673,063	4,971,923	5,320,242	7.01%
Korrik	000 Lek	5,131,751	5,170,237	5,431,700	5,396,671	5,679,494	5.24%
Gusht	000 Lek	5,122,566	5,155,073	5,632,981	5,799,205	6,096,525	5.13%
Shtator	000 Lek	4,715,605	4,756,845	4,821,766	5,042,361	5,203,266	3.19%
Tetor	000 Lek	4,564,099	4,728,006	4,897,273	4,970,781	5,025,241	1.10%
Nëntor	000 Lek	4,870,383	5,135,231	5,522,878	5,311,822	5,284,988	-0.51%
Dhjetor	000 Lek	5,747,799	6,306,116	6,329,766	6,616,246	-	-
Total	000 Lek	60,330,518	62,005,596	63,475,211	64,841,539	60,838,149	-6.2%

Plani i veprimeve të ndërmarra nga OSHEE gjatë 9 mujorit të 2019 arriti të ulë nivelin e humbjeve në masën 22.27% . Sipas bilancit energjistik të OSHEE për 11 mujorin 2019 ka një përmirësim të dukshëm të humbjeve të energjisë me 1.33% në krahasim me të njëjtën periudhë 2018.

Tabela e Humbjeve 11M 2013 - 11M 2019

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Humbjet 11M	44.1%	37.8%	31.0%	27.7%	26.2%	23.7%	22.27%
2019 vs 2018		-6.23%	-6.84%	-3.30%	-1.44%	-2.65%	-1.33%
2019 vs 2017							-3.98%
2019 vs 2016							-5.42%

Krahasuar me të njëjtën periudhë 2017, rezulton ulje e konsiderueshme e humbjeve në masën 3.98% (22.27% në fund të 11 mujorit 2019 ndaj 26.2% në fund të 11 mujorit 2017).

Krahasuar me të njëjtën periudhë 2016, rezulton ulje e konsiderueshme në masën 5.4% (22.27% në fund të 11 mujorit 2019 ndaj 27.7% në fund të 11 mujorit 2016).


OSHEE është në vazhdim të veprimitarisë në përmbushje të planeve për përmirësimin e treguesve të shitjes, i cili është një nga objektivat kryesore të shoqërisë. Ku përfshihen:

- Verifikimi sistemit të matjes
- Sistemimi i kabinave dhe kutive të përbashkëta të matësave.
- Plane pune për verifikime të matjes në kategoritë privatë.
- Kontrollë të veçanta për problematika të evidentuara gjatë procesit të leximit.
- Rritjen e kontrolleve në terren për reduktimin e paligjshmërisë në rrjet.
- Rritjen e kontrolleve të brendëshme me qëllim faturimin sa më korrekt të konsumatorit.
- Ndërgjegjësimin e konsumatorit për rëndësinë e efikasitetit në përdorimin e Energjisë Elektrike .

- Kordinimin e investimeve në rrjet etj.

Energjia e blerë gjatë 11 mujorit 2019, ka pësuar rritje prej 2.6% ose 149 mijë Mwh më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, ndërkohë që shitja e energjisë ka patur një rritje në masën 4.5% ose 198 mijë Mwh krahasuar me 11 mujorin 2018. Për këtë sasi energjie të blerë niveli i humbjeve është reduktuar në masën 1.33%.

Në grafikun më poshtë paraqitet ecuria e faturimit të energjisë për periudhën 11 mujore Janar – Nëntor , 2013 - 2019:



Bilanci Energjetik 11-mujor 2013-2019

3. Treguesit e arkëtimeve për detyrimet e lindura gjatë vitit 2019

Periudha 11 mujore 2019, u karakterizua nga një trend rritës i arkëtimeve prej 3.9% ose 2 mld lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë, e cila është rezultat i përshtatjes më të mirë të kushteve të pagesës së akt-marrëveshjeve të detyrimeve të prapambetura si dhe i rritjes së ndërgjegjësimit të kategorive të konsumatorëve, për nevojën e pagesës në kohë të detyrimeve të konsumimit të energjisë elektrike sipas faturave.

Vlera mesatare e arkëtimeve mujore gjatë vitit 2019 ishte 5.6 mld leke. Arkëtimet nga këstet e akt-marrëveshjeve përbëjnë rreth 4.2% të totalit të arkëtimeve gjatë vitit 2019.

Arkëtimet gjithsej përfaqësojnë arkëtimet për :

- Arkëtimet për faturat e vitit 2019 të cilat për 11 mujorin ishin 49 miliard Lekë.

- Arkëtimet për detyrime të prapambetura 2007-2018 rreth 11.4 miliard Lekë.
- Arkëtimet nga kamatë vonesat rreth 977 milion Lekë
- Arkëtimet nga këstet e akt-marrëveshjeve rreth 2.6 miliard Lekë.

Arkëtimet Mujore për 2013 deri në 11 mujorin e 2019

Muajt/Viti	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Janar	000 lek	2,678,829	3,898,715	6,237,313	5,500,506	5,670,000	6,079,858	6,124,203
Shkurt	000 lek	3,203,142	3,803,400	7,361,546	5,369,530	5,601,988	5,687,049	6,322,886
Mars	000 lek	3,670,407	4,078,872	6,217,910	5,359,217	5,831,491	5,990,434	5,923,357
Prill	000 lek	3,604,305	4,011,620	5,120,272	5,105,759	5,038,018	5,615,429	5,742,354
Maj	000 lek	3,176,144	3,722,527	4,923,611	4,920,953	5,328,851	5,219,627	5,402,251
Qershor	000 lek	2,549,362	3,364,736	4,610,278	4,577,557	4,464,007	4,476,741	4,879,104
Korrik	000 lek	3,223,521	3,497,972	4,884,468	4,741,724	5,132,726	5,221,786	5,682,985
Gusht	000 lek	3,306,363	3,428,280	5,123,593	5,196,623	5,526,253	5,506,297	5,768,661
Shtator	000 lek	3,352,020	4,562,783	5,247,969	4,974,418	5,534,745	5,473,281	5,844,088
Tetor	000 lek	3,212,186	4,098,478	5,101,905	4,814,976	5,205,488	5,480,835	5,570,433
Nëntor	000 lek	2,979,109	4,368,117	4,570,444	4,477,630	4,731,453	4,788,419	4,582,839
11MUJORI	000 lek	34,955,388	42,835,500	59,399,309	55,038,893	58,065,020	59,539,756	61,843,160
Dhjetor	000 lek	3,623,452	6,362,897	5,236,407	5,178,311	5,734,469	5,997,009	
Total	000 lek	38,578,841	49,198,395	64,635,717	60,217,204	63,799,489	65,536,764	61,843,160

OSHEE për qëllime të matjes së performancës, llogarit efektivitetin e aktivitetit të arkëtimeve bazuar në treguesin e Normës së arkëtimet e cila përlllogaritet si raport i: Arkëtimeve mujore ndaj Faturimit të muajit pararendës.

Norma arkëtimet, si rezultat i vazhdimet të aksioneve dhe nënshkrimit te skemave të reja të akt-marrëveshjeve, në fund të 11 mujorit 2019 ishte 98.9% kundrejt 98.7% në fund të 11mujorit 2018. Gjatë vitit 2019, rritja e arkëtimeve krahasuar me të njëjtën periudhe te një viti me parë, është përmirësuar ndjeshëm në kategorinë familjarë dhe privatë në të cilat rritja e arkëtimet të faturave brenda 0-90 ditëve, ndërkaq kategoritë buxhetorë dhe jo buxhetorë vazhdojnë ende një performancë jo të mirë të pagesave.

4. Norma e Arkëtimet për Faturë deri në 90 ditë

5.

Viti 2015

Segmenti	Njësia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2015
Buxhetorë	%	56%	80%	80%	86%	91%	84%	90%	72%	124%	95%	82%	93%	84
Familjarë	%	79%	80%	90%	86%	85%	89%	91%	88%	89%	91%	85%	95%	87
Jo- Buxh	%	38%	47%	47%	23%	68%	41%	42%	20%	31%	27%	34%	28%	36
Privatë	%	85%	84%	88%	83%	89%	97%	93%	90%	88%	100%	90%	99%	91
Total	%	77%	79%	86%	80%	86%	89%	88%	83%	86%	90%	83%	91%	85

Viti 2016

Segmenti	Njësia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2016
----------	--------	------	--------	------	-------	-----	------	-------	-------	--------	-------	-------	---------	------

Adresa : Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

-

Buxhetorë	%	62%	86%	92%	100%	101%	95%	89%	85%	75%	84%	73%	82%	8:
Familjarë	%	84%	83%	92%	87%	95%	89%	92%	92%	89%	93%	91%	95%	9:
Jo- Buxh	%	26%	26%	35%	22%	30%	27%	26%	18%	18%	17%	16%	23%	2:
Privatë	%	90%	89%	96%	90%	99%	92%	91%	97%	94%	99%	90%	94%	9:
Total	%	81%	82%	90%	85%	92%	86%	87%	88%	85%	89%	83%	89%	8:

Viti 2017

Segmenti	Njësia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nënt.	Dhjetor	2
Buxhetorë	%	73%	72%	118%	83%	90%	88%	89%	78%	80%	91%	78%	70%	8:
Familjarë	%	88%	87%	105%	95%	103%	94%	101%	99%	96%	101%	92%	96%	9:
Jo- Buxh	%	36%	33%	73%	56%	37%	31%	25%	48%	42%	48%	37%	58%	4:
Privatë	%	90%	94%	101%	93%	100%	90%	102%	94%	91%	108%	96%	96%	9:
Total	%	84%	84%	102%	90%	95%	87%	94%	92%	89%	99%	88%	91%	9:

Viti 2018

Segmenti	Njesia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qers.	Korr.	Gusht	Shtator	Tetor	Nent.	Dhjetor	9
Buxhetorë	%	75%	98%	111%	81%	103%	77%	90%	76%	78%	90%	58%	90%	7
Familjarë	%	94%	89%	101%	96%	105%	101%	99%	98%	92%	104%	94%	100%	9
Jo-Buxh.	%	37%	48%	67%	54%	72%	35%	75%	63%	47%	47%	45%	71%	3
Privatë	%	94%	95%	98%	95%	102%	92%	97%	94%	87%	106%	88%	102%	9
Total	%	89%	89%	99%	91%	102%	91%	96%	93%	86%	100%	85%	98%	9

Viti 2019

Segmenti	Njesia	Jan.	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	12
Buxhetorë	%	59%	90%	81%	91%	83%	78%	95%	72%	77%	78%	70%	7
Familjarë	%	90%	87%	101%	101%	105%	93%	103%	98%	91%	98%	89%	9
Jo-Buxh.	%	24%	37%	39%	36%	33%	62%	26%	69%	51%	38%	19%	3
